



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 30.4.2014, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Puhie Demaku, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Ylli Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Fisnik Ismajli, Teuta Krasniqi, Sadri Ramabaja, Shaip Shabani, Lirak Çelaj, Memli Krasniqi Blerand Stavileci, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Lirijeta Rexhepi, Laura Zherka, Remzi Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Imer Rusinofci, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviq dhe Cuneyd Ustaibo.

Munguan: Abit Kastrati (me leje), Feim Salihu dhe Vlora Dumoshi.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Kuvendit.

U konstatua se u miratua ky

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Barilevë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave inerte;
4. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998-1999;
5. Propozimrregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme;
6. Propozimrregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;
7. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2014;
8. Informatë për mbjelljet pranverore dhe vërshimet në komunën e Prishtinës;

9. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës;
10. Raportet e komisioneve komunale të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, diskutim;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pra se të fillonin me diskutimin rreth pikave të rendit të ditës, **Lirak Çelaj** propozoi që pika e 11-të, "Pyetje dhe përgjigje", të praktikohet të vihet në fillim të mbledhjes, gjegjësisht në pikën e dytë të rendit të ditës. Në rastet kur kemi ndryshim të ndonjë pike të rendit të ditës, do të duhej që të informoheshim me kohë e jo në mbledhjen e Kuvendit, tha ai.

Agim Salihu theksoi se derisa nuk e rregullojmë çështjen e Rregullores së punës së Kuvendit, ky rend dite është ashtu i përcaktuar, pra "pyetje dhe përgjigje" dhe "të ndryshme" do të jenë pikat e fundit të rendit të ditës.

Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, paraqiti arsyetimin lidhur me ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2013 në vitin 2014, duke thënë se nga Ministria e Financave ka ardhur një korigjim, që ka të bëjë me shpenzimin e mjeteve prej 2400 €, mjete të cilat janë bartur nga të hyrave vetjake në paga, kështu që është propozim i Drejtorisë që ky ndryshim të zbatohet me vendim.

Sami Hamiti u shpreh se ky është një ndryshim teknik, andaj është mirë që ta votojmë dhe ta procedojmë.

U konstatua njëzëri se u miratua propozimi për ndryshimin e Vendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2013 në vitin 2014.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë

Lirak Çelaj bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit. Ai tha se në ekstrakt nuk është përfshirë i tërë diskutimi i tij lidhur me propozimin për rendin e ditës, ku është dashtë të jetë: Unë pajtohem plotësisht me propozimin e z. Gashi për pikën e tetë të rendit të ditës, që të hiqet, sepse nuk kemi pasur asnjë material dhe nuk kemi për çka të diskutojmë, të debatojmë. Pajtohem edhe me propozimin e Yllit, që të hiqet nga rendi i ditës "Raporti i komisioneve komunale të aksionarëve", sepse nuk i kemi materialet e plota. Pas konstituimit të bordeve të reja të aksionarëve, ato duhet të merren me këto raporte dhe ato pastaj të na e sjellin një raport. Të njëjtën gjë edhe për Raportin vjetorë të punës së Kryetarit të Komunës, të shtyhet për seancën e ardhshme, me shpresë se do të na vjen një raport më i detajuar, mbi të cilin mund të diskutojmë diçka.

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, duke thënë se procesverbali nuk po mbahet me kujdesin e duhur. Në pikën e gjashtë, nuk janë shënuar emrat e tre këshilltarëve që kanë votuar kundër dhe pesë të tjerëve që kanë abstenuar. Ne jemi marrë vesh, kështu shkruan edhe në Rregulloren e punës, që së paku të shënohen emrat e atyre që

votojnë kundër dhe atyre që abstenojnë në votim. Për gabimet, së paku të shkallës së dytë, nëse flasim me gjuhën e jurisprudencës, do të duhej të ndërmerreshin masa dhe të ndëshkoheshin ata që i përsërisin. Edhe në vërejtjen që e kamë pasur te pika e parë, nuk është shënuar si duhet. Unë po e kuptoj që është fjalë e huaj *kurrikulë*, le të shënohet bile planprogram.

Agim Gashi theksoi se sekretaria e Kuvendit nuk ka kapacitet që të bëjë korrekturën e materialit. Ne këtë duhet kuptuar, sepse na ka përcjellë vit pas viti, prandaj për të pasur ne një material të thukët dhe përmbajtjesor, të zberthyer, duhet të bëhet korrektimi i procesverbalit, i materialit.

Lirijeta Rexhepi paraqiti vërejtje në ekstrakt, konkretisht në pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhje, e cila tha se në vend të emrit tim është shkruar emri i Floriana Rugovës, andaj kërkoj që kjo të korrigjohet.

Me vërejtjet e dhëna, pesë (5) abstenime (Lirak Çela, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Sadri Ramabaja dhe), u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Barilevë, kryesuesi tha se Bashkësia lokale e fshatit Barilevë ka bërë kërkesë dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka identifikuar parcelën kadastrale për këtë destinim.

Muhamet Selmani tha se paraprakisht kur të vendoset për marrjen e vendimit për këtë lokacion, është edhe një kërkesë tjetër që të caktohen edhe mjetet për rrethojën e këtij lokacioni, sepse është shumë i hapur. Meqë këto do të jenë varreza të reja, atëherë do të duhej bërë edhe plani i varrezave, të caktohen edhe shtigjet e këmbësorëve brenda varrezave, si dhe rrethoja. Besoj se edhe fshatarët janë të gatshëm të participojnë në projekt për rregullimin e këtyre varrezave.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat në fshatin Barilevë.

Pika e tretë

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave inerte.

Agim Gashi informoi se Komuna e Prishtinës që në vitin 2011, është marrë me çështjen e hartimit të projektit për ndërtimin e deponisë së mbeturinave inerte, d.m.th. të mbetura nga konstruksioni dhe demolimi, sepse ka qenë projekti i parë i këtij lloji në Kosovë. Për shkak të disa procedurave dhe mungesës së mjeteve, projekti nuk arriti të realizohet. Projekti parasheh fazën e përgatitjes së deponisë, përkatësisht vendi i përpunimit të këtyre mbeturinave. Nuk është fjala për deponim klasik, por është fjala për fillimin e ndarjes dhe riciklimit të materialit nga konstruksioni dhe demolimi, ku pastaj 80% e këtij materiali

përdoret për tamponizim të rrugëve, nëse vlerësohet nga ekspertët se është materiali më cilësor për ndërtimin e tamponeve rrugore. Pjesa tjetër mund të riciklohet, materiali plastik, metali, druri dhe materialet e rrezikshme që mund të jenë të përziera. Aty mund të deponohet një përqindje e lehtë e materialit që nuk është kontaminues. Kanë qenë komisionet e përbashkëta të Ministrisë së Ambientit, Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtorisë së Inspektionit dhe të gjithë faktorët relevantë të autorizuar për vlerësimin e atij ambienti. Nga komisionet e përbashkëta është konstatuar se liqeni nuk mund të ndotet nga kjo deponi dhe është në vijën e largësisë së mjaftueshme prej liqenit.

Remzi Pacolli theksoi se GP i AKR-së e ka shqyrtuar këtë material që na është ofruar, dhe që në fillim i kam disa vërejtje. Në bazë të arsytimit të cilin e ka paraqitur Drejtoria, thuhet se ky lokacion gjendet buzë magjistrales Prishtinë - Gjilan, por në fakt unë nuk di se ku është. Nga hulumtimet që kam bërë, kam gjetur që kjo parcelë fillon që nga Liqeni i Badocit, Zona kadastrale Hajvali, por pikërisht fillon buzë liqenit. Nuk e di sa janë bërë studime këtu për këtë vend, dhe sa është i përshtatshëm vendi për krijimin e kësaj zone. Parafolësi e ceku se për çfarë do të bëhet dhe si do të funksionoj kjo. Kërkoj të dijë se mbeturinat të cilat hedhen në atë ambient, a do të përpunohen dhe a do të ketë pagesë për hedhjen e atyre mbeturinave.

Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se pas krijimit të deponisë, do të bëhet edhe inspektimi i rrezikshmërisë së ambientit, i cili dërgohet në Ministrinë e Ambientit. Pasi të marrim leje prej tyre, e vendosim saktë se a është ai vend i rrezikshëm apo jo për vendosjen e këtyre mbeturinave. Fillimisht kjo do të jetë si deponi, e më pas do vazhdojë edhe me riciklimin e mbeturinave. Ky lokacion gjendet në pjesën kadastrale të Hajvalisë, përgjatë liqenit të Badocit.

Laura Zherka tha se arsytimin e këtij propozimvendimi e kemi shumë të mangët. Mënyra e administrimit të kësaj deponie të materialeve inerte, është shumë e mangët. Kërkesa ime është për një sqarim pak më të mirë për lokacionin. Në qoftë se është afër liqenit, nuk e di sa do të jetë e shfrytëzueshme në funksion deponia.

Liburn Aliu shprehu mendimin se duhet të shqyrtohet edhe një herë projekti i deponisë, duhet të bëhet një analizë e këtij projekti, pra fillimisht veç jemi në fazën e caktimit të lokacionit. Ky lokacion nuk është buzë liqenit, në kuptimin që e afekton drejtpërdrejtë liqenin. Në projekt do të përcaktohen edhe ato masa që mund të merren në rast riciklimi të mbeturinave, por edhe për ndikimin që mund ta ketë në mjedis kjo deponi.

Mirlinda Sopi theksoi se deponia buzë liqenit paraqet një rrezikshmëri shumë të lartë, por keni parasysh se ai vend është vend turistik. Shihet se me rastin e caktimit të këtij lokacioni nuk është bërë kurrfarë projekti, nuk është caktuar vendi, dhe është sjellë në dokumentacion vendimi për caktimin e lokacionit. Në arsytimin që neve na është ofruar dhe në skicën që ne e kemi në dokumentacion, pikërisht është afër liqenit të Badocit, andaj propozoj që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë dhe kërkoj që të mos përfillet, së paku për momentin, deri sa të bëhen analizat e thukëta dhe më pas të kthehet në Kuvend.

Fadil Gashi ceku se vendi i propozuar për deponi gjendet buzë liqenit dhe nuk është i përshtatshëm për deponi.

Islam Pacolli tha se ky projekt nuk është bërë me një analizë të thukët, si fillim po e marrë qasjen teknike, për peshat e rënda është pak, nuk është e adaptuar fillimisht. E dyta, duke e kuptuar që ne jemi një vend që shumë pak e respektojmë ligjin, për t'u bërë një gjë e tillë, duhet një projekt shumë modern dhe i mirëfilltë, i cili aty nuk mund të bëhet. E treta, është se ajo mund të jetë një zonë turistike ose një kompleks rekreativ-sportiv, jo objekte të mëdha, por për aktivitetet sportive pranverore apo të ndryshme. Rrezikshmëria nga kjo deponi mund të jetë për të gjithë ne që e përdorim ujin e liqenit të Badocit, andaj kërkoj që ta shqyrtojmë prapë, mos ta miratojmë sot.

Feti Mehdiu theksoi se nëse e miratojmë sot këtë propozim, ne përfundimisht kemi hyrë në borxh, pra e kemi marrë përgjegjësinë që nesër të pimë ujë nga ai liqe, i cili ka mundësi të infektohet. Ne sot themi lehtë se lokacioni është larg nga liqeni, por nëse mendojmë për një kohë afatgjate, mos të mendojmë për një vit ose sot për nesër, ose për 10 vjet, por liqeni i Badocit do të jetë edhe pas nesh, prej aty do të duhet të pinë ujë edhe pas nesh. Andaj, unë mendoj për këtë pikë të rendit të ditës që e kemi këtu, mund ta diskutoni edhe pak, mund ta qesim edhe në votim, por nuk e marrë atë përgjegjësi që të votoj, që t'i jepet viza kështu si është, pa këto përgatitje, edhe përkundër asaj që Ministria e Mjedisit ka dhënë vlerësimin, por ne duhet ta shohim se në çfarë baze e ka dhënë atë vlerësim.

Shefki Gashi tha se caktimin e deponisë në atë hapësirë ku, ka mjaft sipërfaqe dhe nuk dëmton asgjë, duhet marr seriozisht. E përkrah qëndrimin që nuk guxon të ketë kontakt ose ndotje të ujit atje, duke e ditur se aty kanalizim dhe rrjedhje të ujit nuk ka, pra është pjesë shkëmbore, që është shumë e përshtatshme, por duhet t'i përmbahet programit teknologjik bashkëkohor. Gjendjen emergjente në Kosovë gati e kemi kaluar, duhet të kalojmë në gjëra të teknologjisë bashkëkohore, prandaj unë si individ, por edhe partia ime, gjërat e teknologjisë progresive do t'i përkrahim gjithmonë.

Lirak Çelaj pyeti se për këtë propozim a ka pëlqim nga Ministria e Ambientit, pra pëlqim mjedisor, dhe a janë pyetur qytetarët, banorët e atij rrethi se a iu pengon atyre diçka në jetën e përditshme.

Ardian Gashi potencoi se për marrjen e pëlqimit nga Ministria e Ambientit, duhet dorëzuar aplikacionin – vendimin e Kuvendit të Komunes.

Liburn Aliu sqaroi se nuk mund të ketë asnjë lloj leje, pa e dhënë Ministria vlerësimin e ndikimit në mjedis, ndërsa sa i përket afërsisë së liqenit, sipas Planit zhvillimor komunal dhe urban, nuk ka ndalesë për vendosjen e deponisë.

Visar Arifaj kërkoi të dijë se si ka ardhur deri te përzgjedhja e këtij lokacione, a ka pasur dhe a ka ndonjë alternativë tjetër nëse nuk pranohet ky propozim.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunes, tha se Drejtoria e Urbanizmit, në përputhje me Planin zhvillimor komunal, e ka përcaktuar këtë lokacion në kuadër të alternativave që i ka pasur në dispozicion. E dyta, në momentin që caktohet lokacioni, atëherë shkojmë në Ministri me kërkesë për pëlqim, andaj pa e caktuar lokacion, Ministria nuk mund të japë pëlqim, se nuk e dinë për çka është duke dhënë pëlqim. Ideja për këtë projekt është që ajo të zhvillohet në një deponi, e cila e riciklon atë material dhe materiali i ricikluar pastaj

përdoret për nevoja qoftë të qytetit, qoftë të kompanive private. Unë kisha kërkuar nga ju që sot ta votojmë vendimin për lokacion, sepse nuk kemi alternativë tjetër.

Ylli Hoxha theksoi se për të sqaruar dilemën se a do të shtrihet buzë liqenit apo buzë rrugës, them se do të ishte e palogjikshme të shtrihej buzë liqenit, sepse nuk bëhet bartja me vapore, as me anije, por shkurt në kamion dhe bartet në deponi. Logjika thotë se shkon afër rrugës, që i bie afër pjesës së fshatit të Hajvalisë, e jo në të kundërtën, pra nga liqeni. Ky problem është ngritur nga qytetarë të shumtë në pjesë të ndryshme të Prishtinës. Është më se urgjente që ta krijojmë një deponi dhe është urgjente që ta funksionalizojmë këtë deponi, në mënyrë që ta pastrojmë qytetin nga kjo shëmti që e ka kapluar.

Lëvizja Vetëvendosje këtë propozimvendim e përkrah për miratim.

Sylejman Pireva tha se rreth këtij problemi ka qasje të ndryshme, andaj dhe këtë problem mund ta shohim nga shumë kënde. Këtu ka vetëm një zgjidhje, që qyteti të mos ngufatet edhe më tutje nga këto mbeturina. A do të jetë kjo zgjidhja më e mirë a jo, është shumë mirë që po diskutohet. Prandaj, konsideroj që zgjidhja duhet të gjendet dhe kjo duhet të përshpejtohet. Konsideroj që kjo zgjidhje, të cilën e kanë menduar ideatorët e saj, është zgjidhje e mirë. Nuk them se këta duke i ikur ngufatjes së qytetit, do të ngufasin një lokalitet tjetër, por le të mendohet mirë se si do të përpunohet ky projekt, se si do të bëhet zgjidhja që të jenë të kënaqur të gjithë.

Imer Rusinovi shprehu mendimin se si Asamble, me këto qëndrime dhe propozime, jemi duke gabuar. Nuk guxojmë ta dërgojmë një propozim të tillë në Ministri, sepse të paktën në agronomi, në materie inerte përfshihen edhe shumë materie kontaminuese, pra duhet të jemi fillimisht të qartë. Çfarëdo rrjedhe e ujit që mund të jetë në kontakt me liqenin, është e ndaluar. Çfarëdo mbeturine e çimentuar që përpunohet, po ashtu mund të jetë me pasoja. Unë nuk jam kundër, por t'i japim problemit zgjidhje pozitive. Të jemi shumë konkret, mendoj se termi, gjegjësisht terminologjia që është, është e gabuar dhe këtu ka nevojë për një ndryshim, qoftë ta quajmë material ndërtimor ose material të fortë dhe të ketë rregulla të caktuara.

Sami Hamiti sqaroi se në bazë të dokumentacionit kadastral, shihet se ajo hapësirë ka një sipërfaqe prej 24 ha, ndërsa përcaktimi i lokacionit është në 7 ha, që është larg liqenit dhe nuk është në rrjedhë të liqenit. Në atë deponi do të përpunohen materialet ndërtimore, që e përfshijnë pjesën e betonit, ndërsa pjesa tjetër, e plastikës dhe e hekurit, do të bartet. Do të deponohet aty vetëm pjesa e dheut që mbetet e që nuk paraqet rrezik. Ky projekt do të kushtojë mbi 2 milion €, projekt i cili është paraparë dhe analizuar shumë mirë. Pozicioni i lokacionit nuk e ka rrjedhën kah liqeni, e ka në anën e kundërt. Ideja është që ajo të zhvillohet në një deponi, e cila e riciklon atë material, ku materiali i ricikluar pastaj përdoret për nevoja qoftë të qytetit, qoftë të kompanive private.

Fisnik Ismaili kërkoi që ky projekt të prezantohet edhe në mënyrën digjitale, kur dihet se janë në dispozicion të gjitha mjetet e teknologjisë, si projektori, interneti etj., në mënyrë që ne ta shohim atë lokacion dhe më pas të marrim vendim.

Muhamet Selmani kërkoi sqarim se pse në Kuvend vjen vetëm një lokacion si propozim, e nuk i kemi disa propozime për këtë qëllim. Pse nuk është konsultuar Ministria, sepse nga informatat që i kemi, në nivel të Kosovës do të jenë dy deponi të mëdha ose tri për këto

çështje? A është paraparë që të bëhet në atë lokacion apo jo? Lidhur me këtë çështje ai ngriti edhe një shqetësim, duke thënë se në fillim të fshatit ku jetoj unë është një deponi e mbeturinave inerte, që tash e tri vjet deponohen mbeturina. Komuna duhet t'i ketë parasysh të gjitha alternativat, të na i sjellë alternativat e mundshme për këto deponi që do të bëhen. Gjithashtu, të merret një pëlqim paraprak nga Ministria për një çështje të tillë.

Xhelal Sveçla, drejtor i Drejtorisë së Inspekcionit, sqaroi se për mbetjet inerte nuk ka tash për tash lokacion, andaj asnjë ndërtues nuk ka faj që e pret gjysmën e natës për t'i hedhur ato mbeturina nëpër vende të ndryshme. Lokacioni i propozuar është i degraduar skajshëm, për shkak se kanë nxjerrë gurë në atë lokacion. Është lokacion ku nuk shihet liqeni dhe nuk ka banorë afër, pra është larg nga zonat e banimit.

Me shumicë votash, dhjetë abstenime (Lirak Çelaj, Memli Krasniqi, Muhamet Selmani, Shaip Shabani, Lirijeta Rexhepi, Lirije Avdiu, Fadil Gashi, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviq) dhe katër vota kundër (Islam Pacolli, Mirlinda Sop, Feti Mehdiu dhe Kimet Zeqa), u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave inerte.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998-1999, kryesuesi hapi diskutimin.

Vjollca Dibra - Ibrahim, në emër të GP të LDK-së, tha se ky memorial simbolikisht zbërthen kontributin e gruas gjatë luftës, si pjesë e rezistencës së vazhdueshme. Kjo është gjëja më e pakët që mund të bëhet për të nderuar këtë kontribut të çmueshëm të tyre. Hapësira e propozuar është e përshtatshme dhe dinjitoze për misionin dhe fillimin e tij, sepse mendohet që ky memorial do të ketë edhe vizitorë, që do ta vizitojnë dhe do të njihen për së afërmi me situatat tragjike dhe të rënda, të cilat i kanë përjetuar edhe gratë tona gjatë Luftës '98-'99. Si grup parlamentar, e përkrahim plotësisht dhe mendojmë se është shumë i domosdoshëm dhe më se i merituar.

Lirak Çelaj në emër të GP të PDK-së, tha se për kontributin e gruas pajtohemi të gjithë, jo vetëm për këtë periudhë, por meqë kjo po i kushtohet vetëm kësaj periudhe, ne e përkrahim këtë propozim për miratim.

Puhie Demaku, në emër të GP-së së Lëvizjes Vetëvendosje, shprehu përkrahjen për miratimin e këtij propozimvendimi.

Sofije Bunjaku, në emër të GP të AKR-së, theksoi se e kemi shqyrtuar këtë material në përgjithësi dhe e përkrahim miratimin e këtij propozimvendimi.

Fadil Gashi, në emër të GP të AAK-LDD-së, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, shprehu mendimin se kufizimi i kontributit të gruas vetëm gjatë periudhës '98 - '99 nuk është i mjaftueshëm, sepse gratë nuk kanë kontribute vetëm gjatë këtyre dy viteve të luftës. Memorialët kanë mesazh universal, gjithëpërfshirës,

e jo të caktuara si janë definuar këtu. Definimi nuk duket në rregull, prandaj ne rezervohemi këtu. Sa i përket simbolikës çka shpreh ajo, qenka miratuar nga një organ atje, por ne mendojmë se pa e parë se çfarë paraqet, çfarë mesazhi ka, çfarë legjende ka ai memoriali, ne nuk do të deklarohe mi për atë.

Visar Arifaj, në emër të subjektit politik Partia e Fortë, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, theksoi se edhe ne si grup parlamentar, do ta përkrahim në shenjë nderimi çështjen e memorialit për kontributin e gruas, mirëpo kjo duhet të vazhdohet edhe gjatë periudhave të tjera, e të mos mbetet vetëm për një periudhë të caktuar.

Me shumicë votash, një kundër (Feti Mehdiu) dhe një abstenim (Fisnik Ismajli), u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998-1999.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimrregulloren për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme, në pika të shkurtra informoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa i kemi dhënë vërejtjet tona. Kemi konstatuar se shumica e pronës këtu brenda është komunale, duke e përfshirë edhe këtë publiken që po i referohemi këtu. Këtë nuk e rregullon një ligj për këmbim të pronës komunale, nuk e citon pronën publike, po ajo pronë publike është pronë komunale dhe me të gjitha normat dhe rregullat, i nënshtrohet rregullave dhe procedurave të dhënies së pronës komunale.

Paraprakisht kjo rregullore në kuptimin e saj edhe te objektet e përkohshme i nënshtrohet, se janë dy definicione të ndryshme këtu. Përcaktimi apo plani i vendosjes së tyre, që duhet të bëhet nga Drejtoria e Urbanizmit, të vendoset në Kuvend, është e vërtet, por kush në dhënie në shfrytëzim të atyre 30 metrave dhe kush të drejtën e vazhdimit. Nuk duhet t'i iket absolutisht, sepse nuk është e rregulluar kështu, nuk duhet t'i iket

Ligjit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim. Edhe në pjesën 2.1, në të cilën thotë vetëm e aprovojmë planin, kurse në pjesën 2.2 nuk aprovohet plani, sepse janë objektet tjera më të vogla, janë panotë reklamuese që duhet t'i nënshtrohen një planifikimi.

Unë pyes se pse ndahet prona komunale prej pronës publike në këtë dhe shkohet vetëm si terminologji *pronë publike*. Ku, në cilën pjesë, në cilin paragraf, në cilin ligj përcaktohet që pronën publike ka me e dhënë në shfrytëzim drejtoria?

Në këtë format ne nuk do ta votojmë, por edhe nëse votohet këtu, unë me shkresë përcjellëse do t'i drejtohem Ministrisë së Pushtetit Lokal, Zyrës ligjore, që ta japë interpretimin e kësaj rregulloreje, sepse nuk është rregullore e cila është e formatizuar apo e shkruar edhe në dispozitiv, në thirrje, andaj konsiderojmë që nuk është e punuar si duhet. Konsideroj se duhet të tërhiqet kjo rregullore, të bëhet kompatible ose të kërkohet mendimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe i Zyrës ligjore. Pra, në këtë format konsideroj që është e kundërligjshme dhe GP i LDK-së nuk do ta votojë.

Ylli Hoxha, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se meqë interpretimi ligjor nga Zyra ligjore na erdhi se kjo rregullore mund të procedohet më tutje, ishim të bindur tek përmbajtja e rregullores dhe nevoja e zbatimit të kësaj rregulloreje me krejt çështjet tjera. Ne kemi nevojë që ta rregullojmë hapësirën publike, ta rregullojmë hapësirën ku kafene e shtrijnë veprimtarinë e tyre, ta përkufizojmë që të mos na hyjnë nëpër hyrje, d.m.th. kemi probleme serioze në qytet, të cilat do t'i zgjidhë kjo rregullore. Për më shumë, konsideroj se është një rregullore shumë e nevojshme, e cila i rregullon disa çështje urgjente që nuk na presin për seancën e ardhshme, sepse kafenetë do të fillojnë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre shumë e më shumë nëpër hapësira publike për shkak të motit më të mirë që po vjen, andaj konsideroj se duhet të përkrahet kjo rregullore.

Lirak Çelaj, në emër të GP të PDK-së, theksoi se rregullorja është relativisht e përgjithshme. Pajtohem se është mirë të kemi një rregullore që e rregullon këtë fushë. Kjo rregullore është relativisht e përgjithshme dhe nuk po shoh se si i rregullon krejt këto gjëra për të cilat diskutoi edhe parafolësi.

Përpos kësaj, unë e kam edhe një vërejtje tjetër. Mënyra se si është përpiluar, nënkupton që vetëm ata që nguten të parët të zënë hapësirën kanë të drejtë, se gjithmonë thonë pasi të vjen kërkesa, por asnjëherë nuk flitet çka nëse Komuna sheh diku një interes për të dhënë qoshqe të tilla ose objekte të tilla dhe e merr iniciativën se si do të procedohet kjo punë, a do të jetë përmes tenderimit, apo si do të shkojë, p.sh. për këndin e librave. Për mua është një çështje mjaft serioze. Pastaj, si do të trajtohen ato objektet që kanë qenë më herët dhe e kanë pasur lejen, cili do të jetë efekti i kësaj rregulloreje në ato objekte paraprake që i ka dhënë leje Komuna?

Kjo është një çështje, për të cilën si Kuvend duhet të marrim një vendim, pra është çështja e shtrirjes së rrjetit kabllor, apo ndoshta mund të flasim edhe për kabllon optike. Komuna duhet ta ketë një operator, një kablllo optike, ku do të kenë qasje të gjithë operatorët tjerë, por e kam përshtypjen se mundësia që secili operator ta shtrijë kabllon e vet optik, do të krijonte një kaos të vërtetë. Ne duhet të kemi një qëndrim të drejtë, që të kemi një rrjet kabllor optik apo cilindo të telefonisë.

Ai propozoi që propozimrregullorja t'i kthehet Komitetit për Shërbime Publike, apo komiteteve përkatëse, të amandamentohet, të përpunohet dhe të silllet përsëri pasi të rregullohen disa nene të tjera.

Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se duke parë të metat që ka kjo rregullore, edhe ne pajtohemi që kjo të kthehet dhe të përpunohet, të bëhen përmirësimet adekuate dhe më pas të silllet në Kuvend për votim.

Imer Rusinovci, në emër të GP të AAK-LDD-së, theksoi se e kemi trajtuar këtë në subjektin tonë politik dhe jemi të mendimit se ka nevojë për ca ndryshime shtesë.

Laura Zherka kërkoi që të jepet një sqarim rreth nenit katër (4) të rregullores, pra një sqarim lidhur me vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën publike deri në realizimin, ku thuhet "*të planeve rregulluese brenda afatit pesëvjeçar*", kur e dimë që këto nuk janë të parapara në asnjë plan rregullues. A do të thotë kjo që ne duhet të presim pesë vite, deri sa të fillojmë me dhënien e lejeve ose pëlqimeve?!

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, shprehu mendimin se dhënia e pronës në shfrytëzim të përkohshëm në afatin prej 15 vjetësh, është pak e lartë, andaj propozoj që ky afat të zbritet dhe të jetë për 10 vjet.

Këtë rregullore mund ta përkrahim në parim që të përpunohet, por nëse kthehet në rishqyrtim që ta rishqyrtojmë edhe njëherë. Është i nevojshëm të bëhet një dallim në mes pronën publike dhe pronës së komunës, për shkak se këtu po duken janë disa paqartësi.

Në parim jemi për gjetjen e zgjidhjes, të përpunohet, të definohen pak më mirë dhe më qartë, atëherë mund të deklarohe mi më qartë edhe ne.

Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, tha se edhe ne mendojmë që kjo rregullore duhet të shqyrtohet edhe njëherë, të definohet më qartë dhe të silllet prapë në Kuvend.

Visar Arifaj, nga subjekti politik i PF-së, tha se në parim e përkrahim, por nëse duhet të përmirësohet, atëherë e përpunuar të silllet për mbledhjen tjetër.

Agim Gashi theksoi se neni 2.1 duhet të vihet në vendimin për dhënien e tokës në shfrytëzim, d.m.th. respektimin e procedurave për dhënien e tokës në shfrytëzim, sepse është fjala për objektin që nuk ka kompetencë drejtoria të japë lejen e tillë. Neni 2.2 duhet të përpunohet, sepse janë disa nënpika, për të cilat Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka kapacitete vlerësimi, siç është fjala te ekranet elektronike etj. Duhet të bëhen edhe harmonizimet e neneve tjera me kërkesat e tjera që janë të domosdoshme.

Do të ishte mirë që kjo rregullore të shtyhet dhe të definohen këto dallime, në mënyrë që rregullorja të jetë plotësisht funksionale.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, që kanë të bëjnë me çështjen e ligjshmërisë, sqarime shtesë dha **Agim Salihu**, shef i Zyrës ligjore.

Kryesuesi tha se përveç që ekziston Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme, ekziston edhe një rregullore, e cila përcakton procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna që kishin të bënin me planet rregulluese, e të cilat ndërlihem me këtë rregullore, **Liburn Aliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dha sqarime shtesë.

Sadri Ramabaja ua përkujtoi të pranishmëve se me një rregullore të ngjashme janë marr edhe para tri vjetësh. Shihet se në neni 2, pikat 2.1 dhe 2.2, është ajo që zgjon kureshtjen më të madhe për t'iu referuar. Kam përshtypjen se çështja e vendosjes së qoshqeve, që ka qenë një tragjedi në vete, çështja e lokaleve të përkohshme, që gjithashtu ka qenë një kaos i krijuar qëllimisht, pastaj çështja e antenave satelitore shpërndarëse, që janë vendosur mbi shtëpitë e banueshme, por edhe në vendet ku nuk do duhej vendosur, sepse rrezikojnë shëndetin etj. Edhe pika 2.2 (b) - panot dhe tabelat reklamuese, jemi dëshmitar që firmat e veçanta vjelin të ardhura të jashtëzakonshme dhe nëse ne ua shtyjme këto afate, siç insistohet sot pa ndonjë shpjegim të saktë, më duket se është një lojë e veçantë.

Ai shprehu mendimin se Komiteti për Politikë dhe Financa nuk e ka shterur diskutimin, andaj tani neve na vjen një material i tillë që, për fat të keq, unë e vërejtja nga diskutimet, dhe kjo është arsyeja pse ne mund ta shtymë edhe pas një muaji. Në parim, unë bëj thirrje që të miratohet, ndërsa vërejtjet konkrete të dërgohen me shkrim dhe të bëhemi pak më serioz gjatë punës.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike dhe vendosjen e objekteve të përkohshme, në thelb nuk dallon, përveç detajizimit të mëtutjeshëm. Në të kaluarën ka qenë edhe më e përgjithshme se që është tash, tash është më specifike.

Sa i përket dallimit në mes pronës komunale dhe pronës publike, besoj se i njëjti trajtim i është bërë edhe në të kaluarën, nuk ka pasur ndonjë trajtim në dallim me anë të Rregullores. Komuna e Prishtinës ka nevojë që të ecën tutje me rregullimin e hapësirave të pronës publike dhe pronës komunale. Ajo çfarë po kërkoj prej juve kuvendarëve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, është që ta votojmë, pastaj ligjshmëritë të na i verifikojë ministria përkatëse, ndërsa neve, si drejtori dhe si ekzekutiv, të na mundësohet të sigurohemi që prona publike dhe komunale të jetë në përputhje me parametra dhe standarde të cilat i shihni në secilin kryeqytet të rajonit.

Kimet Zeqa pyeti se cili Ligj duhet zbatuar për largimin e shkallëve që vihen nëpër rrugë, ku shohim se rrugët dhe trotuaret po zihen vazhdimisht. A është më i rëndësishëm taksapaguesi apo qytetari? Këtu po më intereson kjo, d.m.th. të hyrat. Është e vërtet që kemi nevojë për të hyra në Komunë, por edhe qytetari është shumë i rëndësishëm, sepse shpeshherë qytetari nuk ka nga të kalojë nëpër trotuare nga zënia e kësaj hapësire.

Flamur Shala theksoi se pak po habitem nga nënkryetari dhe shefi i GP-së së Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët po kërkojnë të votohet diçka për të cilën po mendohet se është e paligjshme, prandaj, z. kryesues, hedhe në votim dhe e votojmë apo nuk e votojmë.

Pas hedhjes në votim, ku katërmbëdhjetë vota ishin për, gjashtëmbëdhjetë kundër dhe tetë abstenime (Memli Krasniqi, Fadil Gashi, Muhamet Selmani, Mirlinda Sopi, Islam Pacolli, Lirie Avdiu, Shaip Shabani dhe Sofie Bunjaku), u konstatua se Propozimrregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme, pas korrigjimeve të bëra sipas diskutimeve dhe konsultimeve të marra nga Ministria e Pushtetit Lokal, të sillet për votim në seancën e radhës.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimrregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, Agim Salihu paraqiti arsyetimin rreth harmonizimit të këtij akti komunal me ligjet në fuqi.

Flamur Shala, në emër të GP të LDK-së, tha se përveç plotësimit dhe ndryshimit të kësaj rregulloreje, propozoj që në këtë rregullore të inkorporohet edhe vendimi i Kuvendit, i vitit 2008, i cili ka të bëjë me lirim nga pagesa për kategoritë e caktuara të fëmijëve të vendosur në institucionet parashkollore publike. Përmbajtja e këtij vendimi mund të inkorporohet në këtë rregullore. Do të ishte mirë që me këtë rregullore të rregullohet edhe çështja e liritimit nga pagesa për këto kategori.

Vërejtjet tjera që u potencuan nga z. Shala, kishin të bënin me nenin 14, rreth harmonizimit të datave, por edhe në arsyetimin, ku sipas asaj që është theksuar në arsyetim, del se një vit prapa ka ndodhur vendimi ose është vendosur për ta plotësuar këtë rregullore, andaj në arsyetim duhet të rregullohen edhe këto.

Me këto propozime që i dhamë, është mirë të miratohet kjo rregullore, sepse ka rëndësinë e vet si rregullore, sidomos pika 2.3 që është futur në neni 2.

Jusuf Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, sqaroi se vendimi për të cilin u propozua që t'i bashkëngjitet kësaj rregulloreje, ka të bëjë në mënyrë eksplicite me kriteret, mbi bazën e të cilave lirohen nga pagesa prindërit që i kanë fëmijët e tyre në institucionet parashkollore. Mendoj se ajo nuk ka lidhje me këtë, d.m.th. shfrytëzimi i hapësirave shkollore me lirim nga pagesa për ata që vijnë nëpër çerdhe.

Ylli Hoxha, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se kjo rregullore e definon qartë qiradhënien e objekteve dhe kjo kryesisht ka të bëjë me objektet sportive, të cilat shfrytëzohen nga palët e ndryshme, d.m.th. ekzistojnë kërkesat e ndryshme.

Te pika 2.3, shkronja "d", jemi pajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, por nuk reflekton në këtë draft që të riformulohet kjo pikë, në mënyrë që Federata të jetë ajo që kërkon lirimin e ndonjë klubi nga pagesa, d.m.th. kur ajo e sheh të arsyeshme që ky klub ka nevojë për atë hapësirë shkollore për ta ushtruar aktivitetin e vet. Me këtë formulim, GP i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrah miratimin e kësaj rregulloreje.

Lirak Çelaj, në emër të GP të PDK-së, theksoi se tarifat duhet ndoshta të rishqyrtohen ose këtë pjesën ku lirohen këta për pagesë, të futen edhe organizatat tjera jo profitabile, në mënyrë që këtyre organizatave t'u ofrohet hapësira pa pagesë, ose me një pagesë më të vogël se një euro. Edhe për klubet sportive duhet të bëhet një ndarje, ku për disa raste 1€ ose 15€ ora, mund të jenë tarifa shumë të larta, andaj duhet të shihet cili është statusi i tyre. Ka klube sportive që kanë buxhet të madh dhe ka të cilat mezi mbijetojnë, andaj këtu duhet të bëhet një ndarje më e madhe. Jo gjithçka që paguhet është fitimprurëse, andaj dhe duhet të ndahen. Këto janë të përcaktuara mirë me ligje të tjera, sepse një organizatë e regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, me status të benificuar, sidomos ku transparenca është më e madhe, duhet të merren parasysh dhe të futen në këtë pikën ku mund të lirohen nga pagesa, ose të kenë një pagesë më të ulët sesa tarifat që janë paraparë në pjesën tjetër.

Ai propozoi që në nenin 2, pika 2.3, shkronja "d", pas fjalisë "pjesërisht bëjnë pagesën për t'i mbuluar shpenzimet e mirëmbajtjes së shkollës dhe plotësisht klubet sportive të komunës së Prishtinës, anëtarë të federatave të regjistruara në Republikën e Kosovës", t'i shtohet: "organizatave kulturore dhe edukative, të cilat ushtrojnë aktivitet jo fitimprurës, dhe që konsiderohen me interes publik".

Si grup parlamentar e përkrahën miratimin e kësaj rregulloreje.

Mirlinda Sopi, në emër të GP të AKR-së, u shpreh në përkrahje të miratimit të kësaj rregulloreje, me disa vërejtje që kishte për nenin 6, që i përcakton ose i parasheh tarifat për dhënien me qira të këtyre hapësirave.

Institucionet shkollore zakonisht i shfrytëzojnë klubet e sporteve individuale që nuk kanë të ardhura, apo nuk kanë sponsor të klubeve. Shembull konkret do të ishte Klubi i tenisit, ku tarifa për pagesë 15 € për orë të një salle në shkollat e Prishtinës, është shumë e lartë. Në këtë mënyrë, me këtë rregullore dhe me këto tarifa do të rrezikohet ekzistenca e shumë klubeve në Prishtinë, e aq më tepër sporteve apo klubeve që po tentojnë të hapen. Kërkoj që kjo tarifë të zvogëlohet, nuk dua të përfshihem në atë se kush duhet të lirohet nga pagesa e kush jo, mirëpo mos të trajtohen njëjtë të gjitha federatat. Nuk mund të krahasohen sot

njësoj Federata e Karatesë dhe Federata e Futbollit, nuk i kanë të ardhurat e njëjta, nuk e kanë qasjen e njëjtë, nuk kanë asgjë të përbashkët, andaj kërkoj që të shqyrtohet mirë çështja e tarifave sa i përket kësaj rregulloreje.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, përkrahu miratimin e rregullores, por dha edhe disa sugjerime, me mundësi inkorporomi: Neni 2, pika 2.3, shkronja "d", fjalët "pjesërisht" dhe "plotësisht", janë dy shprehje të cilat disi duken si të paqarta dhe jo të sakta. Neni 6 dhe neni 7, pika 7.1, shkronjat "a, d, e", çmimet që janë dhënë janë shumë të larta. Për këtë është mirë të mendohet, të merren parasysh disa rrethana të mjedisit tonë.

Brahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, u shpreh në përkrahje të miratimit të rregullores, me sugjerimin që në nenin 2, pika 2.3, shkronja "a", në fund të fjalisë të jetë "familjet e dëshmorëve të UÇK-së".

Visar Arifaj, në emër të subjektit politik të PF-së, tha se edhe në këtë rregullore e përkrahim për miratim.

Agim Gashi theksoi se po t'i referohemi nenit 2 të kësaj rregulloreje, ku thuhet se institucionet arsimore kanë këto burime të të hyrave vetanake dhe nuk e përjashton një nivel të institucioneve arsimore, kjo logjikisht del se përfshihen të gjitha të hyrat nga institucionet edukativo- arsimore në buxhetin e Komunës, sepse ato konsiderohen si të hyra vetanake të Komunës, prandaj ky fakt nuk e përjashton propozimin e Flamurit.

Derisa ky fakt nuk e përjashton atë propozim, do të dukej rregullorja shumë e kompletuar në çoftë se vendimin e inkorporojmë në këtë rregullore, ku atëherë do të jetë më lehtë edhe për Drejtorinë të komunikojë me opinionin përmes një dokumenti, se sa t'i zbatojë 2-3 dokumente të caktuara, vendime apo rregullore. Këtu ka qenë qëllimi që të inkorporohen ndryshimet prej rregullores së parë deri më tash në këtë rregullore të veçantë. Duhet të jepet edhe sqarimi për përfshirjen edhe të të hyrave nga institucionet parashkollore.

Blerand Stavileci shprehu mendimin se kur flasim për sportin në përgjithësi dhe aktivitetet e tjera që janë të rëndësishme për rininë dhe sportistët e Prishtinës, duke e trajtuar këtë rregullore, ndoshta po e trajtojmë problemin jo ashtu si duhet.

Po që se edhe klubet e sportit ekipor, por edhe ato individuale, do të kishin hapësira të mjaftueshme, atëherë ne do ta trajtonim këtë temë pak më ndryshe dhe sigurisht që do të ngushtohet rrethi i atyre që do të kërkonin hapësira për t'i zhvilluar aktivitetet e tyre në institucione arsimore. Këtu krijohet balanca midis nevojave për rekreacion dhe argëtuese që i kanë grupet e caktuara të komunitetit dhe të institucionit arsimor, i cili natyrisht që edhe ai duhet të funksionojë të paktën për mirëmbajtjen dhe mos dëmtimin e objektit, t'i ketë disa të hyra. Këtu duhet parë, ndoshta edhe duhet të gjitha këto segmente të caktuara edhe ato që mendohen të lirohen, por edhe të tjerat, për ta gjetur formën më të mirë të mundshme. Nuk mund të ketë asnjëherë rregullore të përsosur, por kjo rregullore të përmbillet shumë shpejt dhe të mendohet në strategjinë se kur do t'i kemi palestrat e reja në Prishtinë.

Shefki Gashi u pajtua me propozimin e dhënë nga znj. Sopi për zvogëlimin e tarifave, pasi që ashtu si janë propozuar, janë shumë të larta. Sa i përket hapësirave sportive dhe rekreative në Prishtinë, nuk ka pasur para vitit 1999, me përjashtim të Pallatit të Rinisë dhe

Sporteve, kurse sa i përket fushave të tjera, nuk ka vendbanim në komunë të Prishtinës që nuk ka fusha sportive. Sot kemi fusha sportive pothuajse në të gjitha shkollat, në të gjitha lagjet e Prishtinës dhe në të gjitha fshatrat. Dallim i madh është prej të 99-ës, andaj nuk pajtohem me z. Stavileci për diskutimin e tij rreth hapësirave sportive.

Në mungesë të Ligjit për kryeqytetin, shumë projekte nga fusha e sportit kanë mbetur pa u realizuar. Po të miratohej ky ligj, atëherë do ta kishim pasur një buxhet më të mirë dhe do ta kishim pasur Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, për të cilin kemi dhënë të holla unë dhe prindërit e shumicës këtu.

Islam Pacolli i përkrahu propozimet e parafolësve. Në veçanti propozimin e znj. Sopi. Ai shprehu mendimin se sporti nuk ka pasur përkrahje, ashtu si edhe zhvillimi i hapësirave sportive në komunën e Prishtinës, jo që nuk janë përkrahur, por kanë pasur pengesa, ku njëri prej tyre kam qenë edhe unë prej 2007-ës, do të thotë për qendër rekreative sportive. Ai kërkoi që për rininë e këtij vendi, për zhvillimin e vendit tonë, të krijohen hapësira, me mundësinë që të zhvillohet sportin.

Kimet Zeqa, sa i përket hapësirave shkollore që i shfrytëzojnë nxënësit, shuma prej 1€ është e lartë, sepse kështu do t'i largojmë edhe fëmijët tanë nga aktivitetet sportive. Nëse nuk i ndihmojmë në këtë drejtim këto biznese, nuk mund ta quajmë biznes që nuk po prodhon asgjë, sepse kjo prodhon shëndet, gjegjësisht rini të shëndoshë. Ne duhet ta përkrahim edhe propozimin e Mirilindës dhe të të gjithë atyre që diskutuan për këtë çështje dhe që mendojnë se shuma 1€ është e lartë.

Sylejman Pireva ngriti shqetësimin lidhur me kafenetë në objektet shkollore, në bodrumet apo anekset e tyre, duke thënë se paska mundësi që edhe ato të lirohen nga kjo qira, njerëzit e caktuar, kategoritë e caktuara. Nëse është ashtu, atëherë le të dihet pak më shumë dhe të flitet pak më shumë se kush shkon në këto kafene, kush kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë ato. Përveç si kafene, ato përdoren edhe si mini-restorante.

Këtë çështje deri më tani nuk e trajtoi askush, andaj dhe mbetet anash kjo, që për mua, si ish-arsimtar i një shkolle dikur, ka rëndësi shumë të madhe, sepse ne e dimë se çfarë mund të shërbehet në ato kafene dhe çka mund të ofrohet atje, por edhe sa është inspekcioni i kujdesshëm rreth furnizimit dhe mbikëqyrjes së këtyre kafeneve.

Përveç kësaj, ai ceku edhe një çështje terminologjike. Në Fjalorin e gjuhës shqipe shprehja "vetanake" nuk ekziston, andaj kërkoj që në vend të kësaj fjale të gjendet një shprehje adekuate.

Sadri Ramabaja theksoi se edhe nga parafolësit u dhanë shpjegime shtesë se kjo rregullore i liron ata që duan të merren me sport masiv dhe publik. Ajo çka më bëri përshtypje është se dy përfaqësues të dy forcave politike, insistuan që të ulet kjo tarifë, që në fakt është për mirëmbajtjen e shkollave, respektivisht për pastrimin e ambientit pas shfrytëzimit të atyre hapësirave. Megjithatë, te neni 6, insistimi për të ulur tarifën flet se këtu ka interesa parciais, ka interesa të individëve që sportin e kanë kthyer në biznes, por nëse bëhet fjalë për çmime, ato janë qesharake. Këto janë për elementin social, ndërkaq ata që kanë të holla, le t'i bëjnë diku tjetër shërbimet.

Brahim Mehmetaj kërkoi nga kryesuesi që kjo pikë të hedhet në votim dhe të mos zgjatet më shumë me diskutime.

Ajnishahe Azemi theksoi se për shkak të numrit të madh të nxënësve që i kanë në klasa dhe punës së madhe që duhet ta bëjnë në klasë arsimtarët, nuk po kanë mundësi t'u përkushtohen sa kanë nevojë fëmijët me nevoja të veçanta, për të vazhduar mësimin në këto klasë të rregullta. Përkundër gjendjes së rëndë financiare që e kanë prindërit e tyre, po detyrohen që të paguajnë asistentë që sadopak t'u mundësojnë fëmijëve një avancim në njohuritë e tyre në klasa të rregullta. Andaj, kërkesë e këtyre prindërve është që Komuna e Prishtinës të kryejë pagesën e këtyre asistentëve, për t'iu mundësuar këtyre fëmijëve vazhdimin e mësimin të rregullt.

Naime Osmani propozoi që në nenin 2, pika 2.3, të futet edhe: *“lirohen nga pagesa edhe fëmijët jetimë”*.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se tani ne po votojmë për bashkëngjitjen e një vendimi në këtë rregullore, vendimi i cili është në fuqi. Pra, po votojmë për amendamentimet e rregullores të cilën e kemi në rend të ditës.

Brahim Mehmetaj shprehu mendimin se vendimi i cili u propozua që të inkorporohet në këtë rregullore, favorizon kategoritë e shoqërisë dhe e lënë anash kategorinë tjetër që është në nevojë dhe ne atë duhet këtu ta diskutojmë. Ai vendim duhet të plotësohet, duhet të rregullohet, pastaj të futet këtu në këtë rregullore.

Jusuf Thaqi drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi se si rezultat i atij vendimi kemi shumë ankesa, sepse ekziston një kategori e njerëzve që nuk janë liruar nga pagesa dhe në ndërkohë, d.m.th. në bazë të ligjeve, disa kategori të caktuara të njerëzve do duhej të përfshiheshin sipas atij vendimi. Si mund të votohet për një dokument, të cilin askush nuk e ka në tavolinë?!

Sami Hamiti theksoi se të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, në këtë rast janë edhe institucionet parashkollore që futen këtu, në nenin 2 janë të përcaktuara edhe pagesat nga prindërit, që normalisht paguajnë kontributin, atë pjesën për participim.

Nëse është kështu, atëherë duhet të kompletohet edhe pjesa e lirimit, nëse ne kemi vetëm për institucione parashkollore. Nëse hiqet çështja e çerdheve, institucioneve parashkollore dhe nuk trajtohet në këtë pjesë, atëherë është në rregull, por nëse trajtohen të gjitha si të hyra vetanake, pse të mos trajtohet edhe pjesa tjetër e lirimit. Le të bëhet ai dokument shtesë, por asnjë të keqe nuk ka që të bëhet një rregullore më kompatible.

Ylli Hoxha tha se në KPF i kemi amendamentuar disa pjesë të kësaj rregulloreje, ku afërsisht jemi pajtuar që kjo duhet kaluar. Tash po propozohet që kësaj rregulloreje t'i bashkëngjitet edhe një dokument, për të cilin ne nuk jemi të informuar dhe po dalim jo serioz.

Kryesuesi e hodhi në votim Vendimin për lirimin nga pagesa për kategoritë e caktuara të fëmijëve të vendosur në institucionet parashkollore publike, i cili do të inkorporohet në këtë rregullore.

Me 24 vota për, nëntë kundër (Sadri Ramabaja, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Puhije Demaku, Qendron Kastrati, Ylli Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Cuneyd Ustaibo, Visar Arifaj dhe Nenad Miladinoviq) dhe dy abstenime (Feti Mehdiu dhe Kimet Zeqa), u konstatua se Vendimi për lirimin nga pagesa për kategoritë e caktuara të fëmijëve të vendosur në institucionet parashkollore publike, inkorporohet në Rregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore.

Me shumicë votash, një abstenim (Qendron Kastrati), u konstatua se u përkrah edhe propozimi i z. Mehmetaj, që në nenin 2, pika 2.3, shkronja a, në fund të fjalisë të shtohet "të UÇK-së".

U konstatua se u përkrah edhe propozimi i z. Çelaj, që në nenin 2, pika 2.3, shkronja "d", pas fjalisë: "... pjesërisht bëjnë pagesën për t'i mbuluar shpenzimet e mirëmbajtjes së shkollës dhe plotësisht klubet sportive të komunës së Prishtinës, anëtarë të federatave të regjistruara në Republikën e Kosovës", t'i shtohet: "... organizatave kulturore dhe edukative, të cilat ushtrojnë aktivitet jo fitimprurës dhe që konsiderohen me interes publik".

Me vërejtjet dhe plotësimet e propozuara, me shumicë votash, u konstatua se u miratua Rregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore.

Pika e shtatë

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me shqyrtimin e raportit tremujor financiar për periudhën janar-mars 2014.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se raporti tremujor buxhetor për periudhën janar-mars 2014, në pajtim me ligjet në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë që i takojnë Komunës së Prishtinës, është përgatitur nga drejtoria përkatëse dhe mbulon tremujorin e vitit fiskal.

Komuna e Prishtinës ka arkëtuar 3 504 886 € të hyra vetanake në periudhën 1 janar - 31 mars 2014.

Të hyrat janë realizuar në shuma të përafërta nga muaji në muaj, pra çdo muaj kemi pasur përafërsisht të hyra të barabarta. Shumica e të hyrave janë nga taksat për leje ndërtimi dhe nga tatimi në pronën e paluajtshme. Komuna e Prishtinës ka planifikuar gjithsej 24 308 000 € të hyra vetanake për vitin 2014, prej të cilave në tremujorin e parë i kemi realizuar 14.41%. Sa i përket tatimit në pronë, realizimi i të hyrave është relativisht i kënaqshëm.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, tha se ky raport është dashtë të jetë i emërtuar pak më ndryshe, përndryshe raporti tremujor për arkëtimet, shpenzimet dhe detyrimet duhet të shkruhet. Ky raport nuk është i inkorporuar me drejtoritë e veçanta, të cilat duhet të kishin dhënë sqarime shtesë dhe të jetë raport i Kryetarit, e jo raport i drejtorit të financave. Për pjesën e të hyrave vetanake, pjesa prej 14% të arkëtimit të mjeteve vetanake, është një normë me 57% të planifikimit, është normë shumë e ultë. Me këtë trend nuk do të mundën të përmbyllen projektet që janë në planifikimin buxhetor.

Për investimet na është dhënë një pasqyrë, për të cilat projekte është paguar ndonjë pjesë, pra atëherë është dashur të inkorporohet edhe Drejtoria e Infrastrukturës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, në pjesën e projekteve të investimeve kapitale që janë duke u punuar dhe nuk është kryer ende pagesa, apo si shpenzim, kështu që është i mangët.

Me këtë formë qysh është duke shkuar, problemi është që arkëtimi i mjeteve nuk do të realizohet në nivelin e planifikuar. Edhe kjo pjesë e detyrimeve do të hiqet prej investimeve

kapitale. Do të ishte mirë që të shohim një ngritje, se tek e fundit një pavarësi apo një zhvillim ekonomik, varet shumë nga arkëtimi i këtyre të hyrave nga procedimi i projekteve në një procedurë. Si përmbledhje, i shkruar si raport financiar është mirë, si raport i Kryetarit nuk i përmbush kërkesat si arkëtim, andaj ne shprehim shqetësim se nuk do të mund të realizohet parashikimi i buxhetit.

Ylli Hoxha, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje, theksoi se ngecja në mos arkëtimin në shkallën e duhur është në dy pika specifike. Ato dy pika specifike kanë të bëjnë me gjendjen kaotike në të cilën është gjetur Komuna. Pra, nëse flasim për ngecje në urbanizëm, bëhet fjalë për ngecje të cilat rezultojnë nga një kaos i trashëguar nga e kaluara, në të cilën fillimisht duhet palosur gjërat, vendosur kornizat e funksionimit të mirëfilltë, e më pas të priten edhe rezultate në arkëtim. Si pikë e dytë, do të ishin shpenzimet në infrastrukturë, që shumë pak projekte janë lënë për realizim në këtë vit. Drejtoria e Infrastrukturës është ballafaquar me mungesë projektësh, është ballafaquar me nevojën për krijimin e projekteve të reja, në të cilat do të shpenzohej buxheti i paraparë. Nuk kam asnjë dyshim se deri në fund të vitit, këto mjete do të shpenzohen pa asnjë problem.

Ne do të krijojmë një plan, me të cilin në fund të vitit do të kemi të hyra shumë më shumë se që ka pasur administrata e kaluar, sepse ky është misioni ynë si organizatë në këtë lëvizje. Konsideroj që jemi në rrugë të mbarë, duke shpresuar se arkëtimi nga të hyrat do të shtohet në raport me administrimin e kaluar dhe vitet e kaluara.

Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, tha se krahas këtij raporti, është dashtë të na prezantohet edhe raporti i tremujorit të vitit të kaluar, për të parë krahasimin se ku kemi mbërritur. Është shqetësues fakti pikërisht te arkëtimi, te të hyrat vetanake nuk ka informacione të duhura. Mungon arkëtimi nga lejet e ndërtimit, si pasojë e pezullimit të një numri të madh të tyre. Te investimet kapitale, është tepër shqetësuese mënyra e investimeve apo shpenzimeve të mjeteve për investimet kapitale.

Në raport janë paraparë gjobat nga trafiku, që do të thotë se shuma prej 650 000 € si e planifikuar nuk qëndron, pasi që ato janë të hyra të paparashikuara. Sukses mund të ketë vetëm nëse tatohet tatimi në pronë dhe tek lejet e ndërtimit dhe të rritet dinamika e punëve në këtë drejtim.

Islam Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se ka shumë arsye dhe mundësi që të plotësohet ky raport, megjithatë përmirësimin e këtij raporti mund ta ndërlikojmë me arkëtimin e të hyrave nga lejet e ndërtimit. Për këtë çështje, sigurisht se ka nevojë që të trajtohet një temë, e që ekzekutivi ta marrin parasysh që të trajtohet taksa e ndërtimit, pasi që deri tash nuk është e sqaruar si duhet. Krahas këtij raporti, do të duhej ta kishim edhe raportin e vitit të kaluar, andaj kërkoj që herën tjetër të sillen këto raporte.

Feti Mehdiu, në emër të GP të PD-së, tha se këtë raport do ta përkrahim kështu siç është, por me një sugjerim. Fjala "gjoba", për të cilën kam rezervë, propozoj që në vend të saj të kemi një formulim tjetër. "Gjoba" është mirë të formulohet kështu: "Kontribut i qytetarëve, të cilët nuk i respektojnë ligjet e Kosovës". Besoj se kjo shprehje mund të qëndrojë pak më mirë.

Brahim Mehmetaj, në emër të GP të LB-së, u shpreh se edhe ne në parim e përkrahim raportin tremujor të buxhetit. Me qëllim të mos përsëritjes së gjërave, ne realisht i mbështesim edhe sugjerimet e parafolësve.

Visar Arifaj, përfaqësues nga subjekti politik PF, tha se do të ishte mirë që t'i kemi edhe pasqyrat paraprake që ta bëjmë krahasimin. Ai parapëlqeu që këto dinamika buxhetore t'i shoh edhe në mënyrë vizuale.

Lidhur me çështjet e ngritura rreth arkëtimit nga lejet e ndërtimit dhe disa çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Liburn Aliu, drejtor i Drejtorisë, dha sqarime të nevojshme.

Agim Gashi theksoi se raportit i mungojnë të dhëna të specifikuar sipas drejtorive, sepse tani unë nuk e di se çka është punuar në x-drejtori, p.sh. në mënyrë që ta kemi një informacion të qartë për këtë tremujor se sa janë zhvilluar projektet e planifikuara dhe cilat ndryshime janë planifikuar, sepse ka pasur projekte që kanë qenë në zhvillim e sipër, ka pasur projekte që kanë qenë të kontraktuara, por nuk e di a janë zhvilluar më tutje, ka pasur projekte që është dashur të shpallen në prokurim etj. Po t'i kishim pasur të gjitha të dhënat, do të kishim një pasqyrë më të qartë dhe do të rezononim pak më ndryshe.

Tani nuk mund të kërkojmë nga secili drejtor, veç e veç, të raportojë për gjendjen në drejtorinë e vetë, sepse as koha nuk lejon.

Çështja tjetër është se gjithmonë raportet i përcjell krahasimi i punës, vlerës, sasisë, etj. etj. dhe kjo mungon.

Lirak Çela kërkoi të dijë se a do të ketë pasoja, ose kush është përgjegjës për financat që nuk kanë arritur t'i arkëtojnë. A do të kenë pasoja në fund të vitit në buxhet, apo do të kompensohen me shtim të dinamikës nga ana e ekzekutivit gjatë periudhave tjera brenda vitit, që në fund të dilët sa më afër zeros, në kuptimin e suficiteve, arkëtimit dhe shpenzimit të buxhetit?

Flamur Shala theksoi se sa i përket arkëtimit të të hyrave vetaneke të realizuara brenda tremujorit të parë, kemi një arkëtim të vogël të të hyrave. Arsyetimi që u dha nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit lidhur me lejet e ndërtimit, është arsyetim i qëndrueshëm, në kuptimin e asaj se disa objekte kanë qenë të parregullta. Si deputet, më intereson në vazhdimësi perspektiva si është duke u zhvilluar lidhur me lejet. Kjo qeveri a ka një program pune, i cili sipas drejtorive, ka një dinamikë dhe në bazë të dinamikës realizohet i gjithë planifikimi buxhetor i të hyrave apo i shpenzimeve. E dyta, nëse ka program, ju kisha lutur që ta kemi në ditur një plan pune, i cili do të na tregonte se ju vërtet jeni duke punuar. Me këtë trend të cilin ju e keni kapur, jeni duke iu kthyer së kaluarës, por është dashur ta bëni një prerje, në mënyrë që ju si qeveri të tregoni rezultatet e juaja, me një përqindje pak më të lartë të të gjithë organizimit buxhetor dhe të realizimit të tij. Qasja e juaj nuk është e mirë, sepse ajo duhet të jetë demokratike, e jo e një qeverie jo stabile, e shkapërderdhur, pa asnjë program as plan pune të saktë.

Hatixhe Hoxha tha se në këtë raport janë pasqyruar edhe tri aktgjykime. Një është në rastin Sahit Shala, tjetri në rastin e Ndërmarrjes Publike Banesore Prishtinë dhe tjetri ka të bëjë me rastin "Arda - Rein", ku totali nga këto shpenzime duket se është diku 1 755 232 €. Janë

detyrime që janë të bartura nga viti i kaluar, e që do të hiqen ndoshta nga buxheti i tashëm. Për këtë kërkoj përgjigje nga nënkryetari. Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit për raportin, arsyetime shtesë dha **Dardan Sejdiu**, nënkryetar i Komunës.

Me shumicë votash, njëzet për, tetë kundër dhe katër abstenime, u miratua Raporti financiar tremujor për periudhën janar-mars 2014.

Pika e tetë

Lidhur me raportet e komisioneve komunale të aksionarëve të NPL-ve - diskutim, kryesuesi hapi diskutimin.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se të gjitha komisionet e aksionarëve kanë pasur obligim ligjor të sjellin raportet e tyre. Disa prej tyre kanë sjell edhe materiale shtesë, dikush ka sjell planin e biznesit së bashku me raportin, dikush ka sjell raport të Bordit.

Sadri Ramabaja, lidhur me raportin e NPL "Hortikultura", tha se ky raport është sjell me disa të dhëna relativisht të mira e të nevojshme. Ajo që kam vërejtur unë ishte çështja e një shume mbi 600 000 €, që i është dhënë në dispozicion ndërmarrjes "Hortikultura". Është raportuar gjithashtu edhe ku është financuar pjesa më e madhe, ndërkaq kanë mbetur 55 000 e diçka euro shtesë prej tyre. Neve si aksionarë të ri, na mbetet të takohemi me Bordin e ri, sepse nuk dihet saktësisht, nuk ka një raport të mirëfilltë për shpenzimet e 555 000 €. Të dhënat tjera që vijnë për të hyrat nga laura (porta) e Gërmisë ose për të hyrat nga parkingjet etj. janë derdhur në Komunë dhe do të ishte mirë të verifikohen, sepse flitet për shumë jo krejtësisht të besueshme. Sipas mendimit tim, por edhe sipas perceptimit të qytetarëve, të hyrat janë më të vogla sesa që do të duhej të ishin.

Kjo ndërmarrje nuk ka borxhe, por nuk është profitabile, pavarësisht se ka një lulishte jashtëzakonisht të mirë, do të thotë pjesa më e madhe e luleve të mbjella, të kultivuara, tash janë produkt i saj, që është për t'u përshëndetur, por, megjithatë, nuk ka arritur të bëhet një ndërmarrje konkurruese dhe profitabile.

Shaip Hajrizi, si anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Hortikultura", tha se në mandatin e kaluar kemi bërë punë aq sa kemi pasur mundësi, duke përcjellë vazhdimisht veprimtarinë e kësaj ndërmarrjeje, e cila, sipas Komisionit, ka qenë shumë e suksesshme, duke përmbushur realizimin e plotë për vitin 2013.

Komisioni komunal i aksionarëve ka pasur bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me Bordin e kësaj ndërmarrjeje dhe, sipas Komisionit, puna e tyre është vlerësuar e mirë. Ne nuk kemi vërejtur diçka që ka qenë e jashtëligjshme. Ne kemi pasur edhe një takim me aksionarët e rinj, me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë për punën e kësaj ndërmarrjeje.

Hatixhe Hoxha tha se raporti i NPL "Hortikultura" është shumë pozitiv dhe vlerësues, por ka disa mangësi të cilat nuk nuk përmenden.

Një çështje që vlen të veçohet është te mirëmbajtja e varrezave, konkretisht te detyrat e kësaj ndërmarrjeje, ku thuhet se mirëmbajtja e varrezave myslimane financohet nga

shërbimet e kryera në varreza, ndërsa shërbimet për komunitetet tjera bëhen pa pagesë. Në raport thuhet se ekziston një memorandum mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Administrimit Publik dhe ndërmarrjes "Hortikultura", vetëm për pastrimin e varrezave të komunitetit ortodoks. Për këtë duhet pasur një qasje shumë pozitive, në mënyrë që të gjithë të trajtohen njësoj.

Lirijeta Rexhepi shprehu mendimin se raporti është i mangët, është shumë përshkrues dhe nuk është raport i detajuar, sidomos financiarisht nuk ka asnjë bilanc, diçka më konkrete që të mund ta dimë se si janë zhvilluar trendët. Edhe raporti i punës nuk ka zhvillim konkret të punës, po merret më tepër me përshkrimin se si janë bërë marrëveshjet midis ndërmarrjeve të ndryshme.

Ajo shtroi një pyetje për ish-aksionarin e kësaj ndërmarrjeje z. Hajrizi. A e dini saktësisht çka ka ndodhur dhe a keni kërkuar llogari, pasi që veç e cekët punën se ka qenë gjithçka korrekte, a është kërkuar nga Bordi i drejtorëve llogari për gropat që janë hapur gjatë fushatës në lagjen "Bregu i Diellit", te shkolla "Ismail Qemali", të cilat ende nuk janë mbyllur dhe nuk është ndërmarr asgjë në këtë drejtim?

Feti Mehdiu theksoi se në raportin e ndërmarrjes "Hortikultura" mungojnë mjetet të varrezat. Mjetet do të mungojnë për shkak se Hortikultura nuk ka pranuar dhe ne ia kemi dhënë vizën që të mos bashkëpunojë me institucionet fetare të Kosovë, dhe ata kanë hequr dorë nga bashkëpunimi me institucionin fetar të Prishtinës. Nëse nuk bashkëpunon me ata që i shtinë njerëzit e vet aty, atëherë ata nuk paguajnë.

Kjo është një përshtypje e imja, për shkak se e kam ngritur këtë shqetësim para 2-3 vitesh këtu në këtë Kuvend, të tjerët e kanë refuzuar atë sugjerim. Unë kam tërhequr vërejtjen se në varrezat e Prishtinës mirëmbajtësi duhet të ketë bashkëpunim me institucionet fetare, e konkretisht këtu ka dallime.

U konstatua se u përkrah Raporti i komisionit komunal të aksionarëve i NPL "Hortikultura".

Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Termokos".

Ajnishahe Azemi, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve, tha se qëllimi i këtij raporti është prezantimi i të arriturave, sfidave dhe ngecjeve gjatë periudhës janar- dhjetor, në realizimin e objektivave të ndërmarrjes për vitin 2013.

Në raport janë paraqitur performancat afariste dhe financiare, të arriturat në prodhim, arkëtimi, ruajtje të pronës, masat për ngritjen e performancës së ndërmarrjes e çështje të tjera. Parametrat tregojnë për një rritje të performancës së ndërmarrjes, sidomos sa i përket ngritjes së nivelit të prodhimit të energjisë termike, rritjes së arkëtimit, uljes së shpenzimeve operationale etj. Faturimi gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012, ka qenë për 13.62% më i lartë. Të hyrat nga arkëtimi i mjeteve për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, kanë qenë për 18% më të larta.

Vlen të theksohet se ka progres në realizimin e projektit kapital të kogjenerimit dhe shpresojmë që sezoni i ngrohjes 2014 -2015, do të fillojë me furnizimin me energji ngrohëse nga termocentrali "Kosova B".

Komisioni i aksionarëve ka pasur një bashkëpunim të mirë me Bordin e drejtorëve dhe kryeshefin ekzekutiv. Në bazë të raporteve periodike që kemi pranuar, kemi vërejtur përgjegjësi, përkushtim dhe profesionalizëm në punë, gjë që ka bërë një ngritje të performancës së ndërmarrjes.

Hatixhe Latifi - Pupovci tha se në rastin e përpilimit të raportit lidhur me performancën e ndërmarrjes "Termokos", komisioni i deritanishëm i aksionarëve është mbështetur në të dhëna që nuk janë të verifikuara. Në raportin e dorëzuar nga Komisioni i aksionarëve mungon raporti financiar i ndërmarrjes. Në raport ekzistojnë vetëm shumat e faturuara dhe shumat e arkëtuar, pa dhënë asnjë detal shtesë për shpenzimin e rrjedhjes së parasë së ndërmarrjes. Ky vlerësim nuk është fare objektiv. Se kjo që po e them është e vërtetë, mund të bazohemi edhe në të dhënat e paraqitura në raport, ku tregohet se "Termokos" qytetarët i ka furnizuar me ngrohje 92 ditë, nga 180 ditët e parapara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Arsyetimet e dhëna në raport tregojnë se ndërmarrja nuk ka mundur ta përmbush objektivin e saj për të siguruar ngrohje gjatë tërë sezonit, për shkak të çmimit të lartë të mazutit. Pra, tregojnë qartë dobësinë e menaxhmentit të kësaj ndërmarrjeje në planifikim të mirëfilltë, duke vendosur objektivat e pa arritshme ose mos angazhim të mjaftueshëm për të arritur objektivat që i ka dhënë vetës.

Laura Zherka theksoi se këtë raport e konsiderojmë jo real krahasuar me performancën e paraqitur. Realisht, furnizimi me ngrohje ka qenë vetëm 4 deri në 6 orë mesatarisht në ditë. Nuk është dhënë as plani njëvjeçar i biznesit për vitin 2013, në mënyrë që t'i bëjmë krahasimet se a janë arritur objektivat, a i përket projektit të kogjenerimit, ky projekt është dashur të përfundoj në vitin 2012. Në raport nuk është paraqitur qartë se deri ku është arritur me realizimin e projektit, përveç se thuhet se është bërë shtrirja e tubacioneve nga "Termokosi" deri te termocentrali "Kosova B", në gjatësi vetëm 3 kilometra, d.m.th. nuk e kemi në përqindje se deri ku është realizuar projekti.

Në raport është dashur të paraqiten edhe humbjet komerciale, përveç humbjeve teknike, d.m.th. kyçjet ilegale etj. Humbjet e ujit dhe shpenzimet me mazut është dashur të jenë dukshëm më të ulëta në raport me kohëzgjatjen e ngrohjes dhe temperaturat të cilat kanë mbretëruar gjatë kohës së dimrit.

Islam Pacolli, sa i përket projektit të kogjenerimit, tha se zvarritja e këtij projekti ka ndodhur pikërisht për shkak të ndërrimit të specifikimit të gypave të trasesë, ku është hequr dorë nga gypat e prodhimit vendor dhe është favorizuar prodhimi i jashtëm, andaj ne nuk mund ta quajmë një menaxhim të mirë, por ky është keqmenaxhim.

E dyta, ka humbje të mëdha, që nuk është cekur këtu saktësisht, por është edhe ajo kur iu kanë ikur legalizimeve të orëve, ku natyrisht se është dëmtuar ndërmarrja.

E treta, shumë punë që janë punuar jashtë të kompetencave të ndërmarrjes "Termokos" apo për të mirën e saj, janë kryer punë si kompani, por pikërisht nga individët që punojnë aty brenda. Kjo kompani nuk ka treguar performancë të mirë dhe nuk ka mundur t'i shërbejë qytetarit në mënyrë efikase.

Sylejman Pireva theksoi se në bazë të përmbajtjes që ka raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Termokos", shihen disa mangësi.

Ndërmarrja "Termokos" gjatë vitit 2013, është financuar me donacione nga Qeveria dhe Komuna në shumën prej 3 500 000 €, këtë fakt nuk e përmend Komisioni, përderisa gjatë

këtij viti, sipas Komisionit komunal të aksionarëve, kjo ndërmarrje ka arkëtuar 1 467 249 € dhe vlerësohet si afarizëm pozitiv. Sipas një rregulloreje, "Termokos" është i obliguar të ndërtojë në rrjetin sekondar, ndërsa konsumatorët janë të obliguar të paguajnë përmes faturave, por kjo në terren nuk ndodh. Vlerësimi i menaxhmentit të ndërmarrjes për sistemin e kogjenerimit nuk qëndron, sepse kogjenerimi nuk është vepër e tyre.

Kjo ndërmarrje ende punon me rregullore të vjetër, e cila arkëtimin ende e bën derë më derë të konsumatorëve, kur të gjitha këto të tjerat këtë çështje e kanë rregulluar në mënyrën më bashkëkohore.

U konstatua se u përkrah Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Termokos".

Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve"

Lirije Avdiu, lidhur me këtë raport tha se, meqenëse ky raport ka ardhur shumë vonë, propozoj që të shtyhet dhe të shqyrtohet në mbledhjen tjetër të Kuvendit.

U konstatua se Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve", shtyhet për diskutim për mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të KRM "Pastrimi"

Genc Sherifi tha se ky raport është shumë i mangët, ku më shumë janë të përshkruara në mënyrë sipërfaqësore obligimet dhe detyrat që ka kjo kompani, sesa një puna e realizuar brenda një viti nga kjo ndërmarrje. Në bazë të informatave që kemi nga punëtorët, por edhe nga ato të mediave, që nga marrja e detyrës së drejtorit nga z. Feim

Salihu, në këtë ndërmarrje është bërë punësimi i jashtëligjshëm i disa familjar të tij, por edhe i mbi 70 punëtorëve nga strukturat e partisë dhe ndërmarrjeve të tjera publike, që e kanë qar po thuajse në falimentim këtë ndërmarrje. Edhe sa i përket punës, shumë lagje të qytetit dhe lagje rurale nuk pastrohen.

Për të gjitha këto që i ceka, kërkoj përgjigje.

Merita Surkishi theksoi se çështjet e ngritura nga z. Sherifi nuk qëndrojnë, nga fakti se kjo ndërmarrje që nga viti 2010, ka shtuar numrin e klientëve për 24%. Ka pasur edhe shumë gjëra të tjera pozitive që e kanë shtyrë procesin përpara në këtë ndërmarrje.

Ibrahim Mehmetaj u shpreh se këtë raport e lexova me vëmendje dhe konstatova se askund nuk e pash raportimin që ka të bëjë me arkëtimin e mjeteve e, në anën tjetër, traktorët e ndërmarrjes i japin me qira e punojnë nëpër ara.

U konstatua se u përkrah Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të KRM "Pastrimi".

Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore

Mustafë Krasniqi tha se Komisioni komunal i aksionarëve ka përcaktuar politikën e pronësisë dhe rolin e saj në qeverisjen korporative të ndërmarrjes.

Komisioni komunal i aksionarëve në bazë të përgjegjësive që ka, më 09.10.2012, ka zgjedhur Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes. Është caktuar me vendim kompensimi për drejtorët e Bordit dhe është kujdesur që aktet e ndërmarrjes të miratuara, të ndryshuara dhe të plotësuara të jenë në harmoni me Ligjin për ndërmarrjet publike.

Pasqyrat financiare janë paraqitur në tabelë, ku shihen të hyrat, shpenzimet, fitimet, humbjet, amortizimi, borxhet dhe paraja e mbetur në vlerë 1 777 659 €.

Misioni i ndërmarrjes është afrimi i shërbimeve të qëndrueshme, të suksesshme dhe shërbimeve konkurruese në përputhje me nevojat e shoqërisë.

Si përfundim, Komisioni komunal i aksionarëve vlerëson se performanca e kompetencave dhe përgjegjësive të parapara me ligj, arritjet dhe objektivat e pronësisë dhe sigurimi i të dhënave të qëndrueshme për Kuvendin e Komunës dhe qytetarët është e kënaqshme.

Qëndron Kastrati tha se sa i përket fushëveprimit kryesor të kësaj ndërmarrjeje, që pretendohet për ndërtim të objekteve banesore, afariste, industriale, administrative, arsimore, shëndetësore etj., besoj se në këtë aspekt nuk është bërë sa duhet.

Fushëveprimi tjetër është mbikëqyrja, projektimi, revidimi i projekteve, kontrolli teknik i objekteve dhe pranimi teknik, e që edhe në këtë aspekt nuk kanë qenë të angazhuar sa duhet. Në raport është cekur se transparenca është rritur, por realisht transparenca në ndërmarrje është në nivelin zero. Arsyeja është se në bazë të Statutit, obligim i ndërmarrjes është të ketë faqe elektronike zyrtare. Në realitet, asnjë dokument i ndërmarrjes nuk mund të gjendet në internet ose publikisht. Sa i përket menaxhimit, mund të konstatojmë se nga viti 2010, kjo ndërmarrje ka humbur më se tetë milion e gjysmë euro gjatë tërë mandatit. Kjo ndërmarrje ka trashëguar shumë prej katër milion euro, të cilën nuk ka arritur ta arkëtojë. Gjatë gjithë mandatit ndërmarrja nuk ka miratuar asnjë rregullore apo akt të brendshëm qeverisës, përveç Statutit. Nuk është e rregulluar si dhe kush ka të drejtë të marrë në shfrytëzim pronat e ndërmarrjes.

Çështje tjetër shqetësuese është edhe nepotizmi, një dukuri shumë e theksuar, ku ka shkelje të drejtpërdrejta të Ligjit për parandalim të konfliktit të interesit. Nuk ka pasur qasje serioze për uzurpuesit e pronave të ndërmarrjes. Korrupsioni është një dukuri shumë e shprehur në këtë ndërmarrje, pranimi i punëtorëve pa konkurs, ngritja në pozita etj. Pra, këto ishin disa nga të metat që e kanë përcjellë menaxhimin e Ndërmarrjes Publike Banesore.

Islam Pacolli shtroi pyetjen se si është e mundur që njerëzit me vite të tëra t'i shfrytëzojnë lokalet dhe mos ta kryejnë obligimin e qirasë.

Me vërejtje dhe sugjerime, u konstatua se u përkrah Raporti i Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Banesore.

Pika e nëntë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës, kryesuesi tha se përfaqësuesit e katër drejtorive i kanë sjellë propozimet për anëtarë të këtij komisioni dhe tani duhet të propozohen edhe anëtarët e tjerë nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit.

Nga GP i LDK-së u propozua Vjollca Dibra - Ibrahim.
Nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje u propozua Ibrahim Mehmetaj.
Nga GP i PDK-së, u propozua Lirije Avdiu.
Nga komuniteti intelektual u propozua Binak Ulaj.
Nga GP i AKR-së u propozua Mirlinda Sopi.

Kryesuesi gjithashtu njoftoi se nga Shoqëria civile propozohet Sali Shoshi, ndërsa për përfaqësuesin e fshatit, kryetarin e Bashkësisë lokale dhe një përfaqësues të rrugës ose të lagjes në qytet, mbetet të caktohen më vonë.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës.

Pika e dhjetë

Lidhur me Informatën për mbjelljet pranverore dhe vërshimet në komunën e Prishtinës, të pranishmit i informoi Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës.

Ai fillimisht u përqendrua rreth mbjelljeve pranverore, duke thënë se ekziston një planprogram për mbjelljet pranverore, i cili përgatitet çdo vit nga drejtoria përkatëse, përkatësisht nga Sektori i bujqësisë.

Planifikimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2014 është: misër për kokërr 278 ha, misër me fasule 31 ha, misër i gjelbër 61 ha, elb 18 ha, tërshërë 38 ha, bimë foragjere 29 ha, perime 61 ha, patate 265 ha, fasule monokulturë 37 ha, jonxhë 25 ha dhe tërfil 22 ha, gjithsej 865 ha. Është themeluar edhe komisionin për subvencione në bujqësi, gjegjësisht një komisionin për caktimin e kriterëve dhe një komisionin për shpërndarjen e subvencioneve.

Sa i përket dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, do të informoi drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se të reshurave atmosferike që ishin kohëve të fundit e kanë përfshirë edhe territorin e komunës së Prishtinës. Më 18.4.2014 kemi pasur vërshime, por duke parë rrezikun se mund të ndodhin edhe vërshime të tjera në ditët në vazhdim, bashkë me drejtoritë përkatëse, kemi krijuar grupet punuese dhe kemi dalë në terren. Për t'iu dalë në ndihmë zonave të rrezikuara, kanë qenë të angazhuar edhe Njësia e zjarrfikësve, Policia e Kosovës, Forcat e Sigurisë së Kosovës, si dhe kompanitë publike dhe ato private. Pikat më kritike ishin në Fushën e Pajtit, apo te kolektori, pikë e cila është monitoruar në çdo kohë. Gjendje kritike ka qenë edhe përreth pjesës së rrjedhës së lumit Prishtina, d. m. th. në fshatrat Makoc e Llukar dhe rrjedha tjetër që shkon për në Ballaban dhe Keqekollë. Vërshime ka pasur edhe në Zllatar, Mramur, Bërnice, Siqevë dhe në fshatrat përreth rrjedhjes së lumit Llap. Me qëllim të ndihmës për këtë gjendje të krijuar, janë formuar edhe komisione për vlerësimin e gjendjes faktike si pasojë e këtyre vërshimeve.

Nga kjo mund të konstatojmë se me infrastrukturë të dobët, me uzurpim të pronave përreth rrjedhës së lumenjve dhe hedhjen e mbeturinave vend e pa vend, janë krijuar kushtet që lumi, në pamundësi të përcjelljes së sasisë së madhe të ujit, të dalë nga shtrati dhe të krijohen vërshime.

Mirlinda Sopi përgëzoi angazhimin e organeve komunale në evitimin dhe parandalimin e pasojave të mundshme nga vërshimet e shkaktuara. Ajo shtroi edhe pyetjen e disa banorëve të fshatit Makoc, lidhur me dëmtimin e urës së këtij fshati: Çka do të bëhet me urën e dëmtuar dhe a do të merret ndonjë masë për ndërtimin e saj?

Shefki Gashi tha se këto janë gjëra që ndodhin, është fuqia mbinatyrore që mund të ndodh gjithkrah në botë, por për fat të mirë që nuk ka dëme në njerëz.

Pasojë e këtyre vërshimeve mund të jetë edhe përkeqësimi i shtratit të lumenjve, sepse ka vite të tëra që nuk ka pasur reshje të mëdha. Do të ishte mirë që komisionet e formuara të merren kryesisht me shtratin e lumit dhe me rrugët që janë dëmtuar. Ka edhe dëmtime të pronave, por ato janë më të vogla. Sa i përket rregullimit të shtratit të lumit në fshatin Llukar, pa rregullimin e kanalizimit nuk do të ketë stabilizim të kolektorit të Fusha e Pajtit. Aty ka edhe probleme pronësore, por ato duhet të kompensohen, përndryshe nuk do të ketë stabilizim të vërshimeve as nuk ka stabilizim në pastrim të ujit të pijshëm, sepse ato puse janë buzë lumit.

Sami Hamiti theksoi se këto janë raste që ndodhin, e që nuk mund të menaxhohen lehtë dhe pas gjithë këtyre të reshura, është normale që krijohet një situatë emergjente. Situata është menaxhuar mirë, në një pjesë kam qenë në kontakt edhe me njerëzit, sidomos të Fusha e Pajtit, sepse gjithmonë atje, derisa është ndërtuar kolektori, e kemi pasur problemin më të madh gjatë reshjeve.

Për shkak të uzurpimit të pronave përreth vijës së lumit, kemi edhe ngushtimin e shtratit të lumit, dhe si pasojë kemi edhe vërshimet.

Sa i përket problemit të rrjetit të kanalizimit të objekti i ri i Shkollës teknike, aty është një infrastrukturë që ka mbetur gjysmake, e cila nuk është bërë nga Komunës, andaj për problemet që lidhen me kanalizim, duhet pasur qasje tjetër, pasi që aty nuk kemi investim të Komunës. Komisioni i formuar, në përbërje të 11 anëtarëve, le t'i vlerësojë ato dëme. Konsideroj se ka mundësi t'u ndihmohet me një shumë të mjetesh nga buxheti, sepse është bërë edhe viteve parapake kur kanë ndodhur vërshime të tilla.

Hazir Borovci falënderoi Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për qasjen e shpejtë që e kanë treguar në evitimin dhe parandalimin e pasojave të mundshme nga vërshimet në fshatin Zllatar.

Ardian Gashi informoi se komisionet janë duke punuar në evidentimin e dëmeve të shkaktuara në pronat private. Sa i përket urës në Makoc, atë e kemi prishur ne, sepse ka qenë e ndërtuar shumë ulët dhe është dashur të hapet vija e rrjedhës së ujit që të mos del nga shtrati. Këtë urë do ta rinovojmë brenda një afati sa më të shkurtër kohor.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për mbjelljet pranverore dhe vërshimet në komunën e Prishtinës.

Pika e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë

Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme.

Puhije Demaku tha se para fillimit të seancës, znj. Kimete Zeqa më ka njoftuar se 12 maji është Dita Ndërkombëtare e Infermierisë dhe ne, si grup i grave, kushdo që të ketë mundësi, atë ditë të marrim pjesë dhe të dhurojmë gjak. Pra, në emër të znj. Kimet Zeqa, ju bëj apel që të na bashkëngjitet në këtë iniciativë kushdo prej këshilltarëve. Do të ishte iniciativë dhe gjest i mirë që të shkojmë së bashku, por kjo nuk do të limitohet vetëm tek këshilltarët, besoj se pjesë e kësaj nisme do të jetë edhe ekzekutivi.

Lirijeta Rexhepi theksoi se, me që kanë filluar punimet në rrugën “Xhemajl Berisha”, në lagjen “Velania”, për vendosjen e gypave të ujit, propozoj që të bëhet edhe zgjidhja e një problemi të një rruge. Në emër të qytetarëve të një pjese të lagjes “Velania”, të cilët i janë drejtuar Komunës edhe përmes peticionit, kërkoj hapjen e rrugës “Hamdi Gashi”, rrugë e cila është e bllokuar me dyer, të cilat janë vendosur për arsye të sigurisë së shtëpisë së ish-Presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova. Dy vjet më parë është marr vendim për hapjen e kësaj rruge, por ajo ende është e mbyllur. Kërkoj që të merren hapa konkretë që të lirohet rruga për qarkullim.

Lirak Çelaj, lidhur me punimet në rrugën “Xhemajl Berisha” në lagjen “Arbëria”, tha se kam biseduar me nënkryetarin dhe kemi konstatuar se punimet nuk janë proceduar, por edhe komunikimi me qytetarë nuk ka qenë në nivel. Tash e tutje, jo vetëm në këtë lagje, por kudo që të jetë, do të duhej informuar ata banorë me dinamikën e punimeve. Si pasojë e kësaj, janë mbledhur qytetarët dhe i kanë bllokuar punimet për disa ditë. Meqë kaloj atypari për çdo ditë dhe e shoh gjendjen nga afër, mendoj se është mirë që të merren masat e sigurisë, sepse shpesh hapen gropa dhe nuk mbyllen fare. Në këtë drejtim duhet shtuar kujdes në tërë qytetin, sepse shpesh mbeten gropat e hapura, ku si pasojë mund të rrezikohen kalimtarët, makinat edhe të gjithë të tjerët.

Lidhur me këto dy propozimet tuaja, sigurisht që do t’i merr parasysh ekzekutivi, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës Lokale, por një sqarim do ta japë edhe nënkryetari.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i KK-së së Prishtinës, tha se kam komunikuar me z. Çelaj dhe menjëherë pas atij komunikimi, kam shprehur brengën në kompaninë e ujësjellësit rajonal “Prishtina” jo vetëm si Komunë, por edhe si qytetar i Prishtinës.

Kam kërkuar prej tyre që para se të intervenojnë në infrastrukturë, të koordinohen me Drejtorinë e Infrastrukturës dhe drejtoritë e tjera përkatëse, në mënyrë që t’i informojmë qytetarët. Ata na kanë premtuar dhe janë zotuar që tash e tutje nuk do të ketë gjëra të tilla. Shpresoj se do të tregohen të vëmendshëm para se të fillojnë punimet dhe të na informojnë me kohë.

Sylejman Pireva preku çështjen e objektit të Bibliotekës së qytetit “Hivzi Sylejmani”, duke theksuar se nuk di kush ka faj më shumë, por konsideroj që fajin duhet ta marrin të dy qeveritë, aq sa i takon le ta marrë secila për vete, ajo që ka shkuar dhe kjo që është tash. Ne presim me vite, mos të them me javë e me muaj, që t’i bartim koleksionet e Bibliotekës në objektin e ri, për të cilin heshtet dhe nuk jepet asnjë informatë se çka është duke ndodhur me të. Kërkoj që në mbledhjen e radhës, të jepet një informatë e saktë edhe nga kjo qeveri, edhe në bashkëpunim me qeverinë tjetër, kushdo që janë përfaqësues të saj, që të dihet e vërteta se çfarë është duke ndodhur lidhur me këtë çështje. Përndryshe, them se janë më

shumë se 20 mijë libra të vendosur në paketa, e që presin orën, minutat për të qenë në shërbim të lexuesve.

Visar Arifaj kërkoi të dijë se kush e menaxhon faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës. Ai theksoi se të gjitha dokumentet zyrtare, përfshirë edhe rregulloret dhe vendimet, janë në format të skanuar dhe nëse do të bësh ndonjë kërkim për të gjetur se çka ka në përmbajtje të tekstit të atyre dokumenteve, është e pamundur ta gjesh në këtë formë si është tash. Për të pasur një qasje më të lehtë në ato dokumente, do të ishte mirë që ato të jenë në formë digjitale.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se sa i përket çështjes së Bibliotekës së qytetit, ka filluar një procedurë disiplinore ndaj atyre që e kanë zvarritur procesin, kështu që në mbledhjen e radhës së Kuvendit do të informojmë se kur do të jetë funksionale biblioteka, që lexuesit ta kenë në dispozicion një hapësirë më të mirë.

Për ueb-faqen e Komunës, theksoi se ajo është duke u ridizajnuar në tërësi, ku dhe tani disa prej punëve mund të bëhen edhe drejtpërdrejt (online). Besoj që për një afat të shkurtë kohor, do të kemi një ueb-faqe të ridizajnuar dhe që do të funksionoj si duhet.

Mbledhja mbaroi në ora 17:45

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.**